

VENDIM
Nr. 342, datë 19.4.2017

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS NDRYSHUESE TË QIRASË, ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË “LIBEREST”, SH.P.K., PËR PASURINË “AGJENCIA E REZERVAVE TË SHTETIT DORËZ, KOMUNA QENDËR, LIBRAZHËD”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës ndryshuese të qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “Liberest”, sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Agjencia e Rezervave të Shtetit Dorëz, komuna Qendër, Librazhd”, të miratuar me vendimin nr.637, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE TIRANE

Nr. _____ Rep.

Nr. _____ Kol.

KONTRATE NDRYSHUESE QIRAJE
Me tarifë simbolike 1 euro kontrata

Në Tiranë, sot me datë _____ të muajit _____ të vitit 2017 (dymijë e shtatëmbëdhjetë), u paraqiten para meje noterit _____, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, përfaqësuar nga Z. _____, i pajisur me letërnjoftimin nr., me detyrë _____ në këtë Ministri, në bazë të autorizimit të Ministrit, Nr., datë, që më poshtë do të quhet **“QIRADHËNËSI”**,
Dhe

Shoqëria “LIBEREST” sh.p.k., me seli në ish Magazinat e Rezervave të Shtetit, Togës, Librazhd, e regjistruar si person juridik dhe pajisur nga Q.K.B. me numër identifikimi L47606601G, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë Z. Ismail Kadiu, i pajisur me letërnjoftimin nr., madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që më poshtë do të quhet **“QIRAMARRËSI”**.

Të cilët deklaruan se, mbështetur në pikën 3 të kreut IV “Nxitja e Biznesit” të Vendimit nr.54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, në vijim të Vendimit nr.637, datë 01.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën simbolike 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë “Liberest” SHPK, si qiramarrës, për pasurinë “Agjencia e Rezervave të Shtetit Dorëz, komuna Qendër, Librazhd”, si dhe në nenet 801-825 të Kodit Civil, Ministria e Zhvillimit të Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me cilësinë e “Qiradhënësit”, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë qiramarrëse “LIBEREST” sh.p.k. për një ndryshim në treguesin e punësimit të planit të biznesit nisur dhe aktorë dhe faktorë të zonës, palët bien dakord që në kontratën e qirasë, nr.540 Rep. dhe nr.114 Kol., datë 05.11.2014, të lidhur për pasurinë “Agjencia e Rezervave të Shtetit Dorëz, Komuna Qendër, Librazhd”, njësi në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, të bëhen ndryshimet si vijon:

1. Plan biznesi që i bashkëlidhet kontratës dhe që përmendet në pikat 5.4, 5.5 dhe 10.2 të kontratës së qirasë, zëvendësohet me planbiznesin që i bashkëlidhet kësaj kontrate ndryshuese qiraje.
2. Neni 5.6 i kontratës së qirasë riformulohet si më poshtë:

“5.6 Qiramarrësi” sipas parashikimit për punësimin të shprehur në plan-biznesin, bashkëngjitur kësaj kontrate, detyrohet që në objektin e marrë me qira, të realizojë punësimin e jo më pak se 55 personave. Të punësuarit e realizuar nga nënqiramarrësit në këto ambiente, të njihen si vende pune të hapura sipas nenit 5.6 të kësaj kontrate.”

Kjo kontratë ndryshuese, është pjesë përbërëse e kontratës së qirasë nr.540 Rep. dhe nr.114 Kol., datë 05.11.2014 të lidhur për pasurinë “Agjencia e Rezervave të Shtetit Dorëz, Komuna Qendër, Librazhd”, njësi në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kontrata ndryshuese e qirasë është formuluar në gjashtë kopje origjinale dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe pranuan, e nënshkruan atë para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë dhe unë noter _____, në bazë të nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë rregullisht.

QIRADHËNËSI:

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
Përfaqësuar nga:**

QIRAMARRËSI:

**Shoqëria “LIBEREST” SHPK
Përfaqësuar nga:
Ismail Kadiu**